



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTEI Ë SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga 1123/1
P. A. DIBËR dhe mban nga dërguesi nr. _____ prot.
datë 18/12 2025 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda) _____

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot. _____ datë
18/12.2025 5028/1

Praktika u drejtohet për administrim:

- Znj/Z _____
- Znj/Z Shërbimi të Punëve Publike
- Znj/Z _____
- Znj/Z _____

me porosinë: _____

Administrimi praktikën e tyre sipas ligjit

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes,..etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë _____

Sipas afatit

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore: _____

Peshkopi, më 18/12 2025

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

[Signature]



5028/18/12/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1123/1 prot.

Peshkopi, më 18.12.2025

Lënda: Për vendimin nr.90, datë 05.12.2025 të Këshillit Bashkiak Dibër.

BASHKISË DIBËR
KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

DIBËR


Me shkresën nr.5028, datë 12.12.2025, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër është paraqitur vendimi nr.90, datë 05.12.2025 i Këshillit Bashkiak Dibër me objekt: "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dibër".

Lidhur me miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dibër, institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër ka mbajtur qëndrim me shkresën nr.1022/1 datë 12.11.2025.

Në vlerësim të institucionit të Prefektit, rregullorja përkatëse është një akt normativ me të cilin janë miratuar norma, standarte e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e shërbimit të transportit publik dhe para miratimit të tij, për sa parashikohet në nenet 18 dhe 54 shkronja "k", duhen zhvilluar seanca këshillimi me bashkësinë.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 90 Datë 05 /12 /2025

“Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dibër”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1, germat 'a' dhe 'b', nenit 64, germa 'a' dhe 'b' të ligjit nr. 139/2015 'Për veteqeverisjen vendore'; Ligjin nr. 8308, date 18.03.1998 'Për transportet rrugore', i ndryshuar; Ligji Nr. 8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë “ i ndryshuar, VKM nr 325 date 19.03.2008 “Për përcaktimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare të caktuara për këta operatorë” i ndryshuar, Udhezimin nr 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve , rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” i ndryshuar, Udhezimin nr.15 datë 24.07.2007. “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” i ndryshuar. Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **05.12.2025** me propozim të Kryetarit të Këshillit shqyrtoi kthimin e VKB Nr.77 nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër dhe me 19 vota pro 0 kundër 0 abstenim :

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në Bashkinë Dibër, sipas aneksit 1, bashkelidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër
4. Vendimi u shpall më datë **05.12.2025**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

